



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. Prot. 5262/1

Tiranë, më 13/10, 2020

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Z. Gentian DEVA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
Z. Arben RAKIPI
DREJTOR I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Për dijeni:

INSTITUTIT SHQIPTAR TË SHKENCAVE
Znj. Aranita BRAHAJ
DREJTOR EKZEKUTIV

Tiranë

Në vijim të shkresës së përcjellë nga ana e Institutit Shqiptar të Shkencave me Nr.Prot. 5262 datë 13.10.2020, me lëndë "Propozim Plan Veprimi OGP 2021-22, Krijimin e Regjistrit të Magjistraturës, Komponentët Drejtësi dhe Digjitalizim", si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 673 datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar, ju bëjmë me dije se:

Referuar kërkesës së ISHSH për krijimin e Regjistrit të Magjistraturës, ku përfshihet Pjesa e Administratës dhe Pjesa për Akses Publik, si regjistër i dixhitalizuar dhe elektronik, si një detyrim ligjor i vendosur nga Ligji nr.96/2016, sugjerojmë ngritjen e një grupi të përbashkët pune ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës, Institutit Shqiptar të Shkencave dhe AKSHI, për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimin e kritereve të veçanta për procedurën "Ngritja e Regjistrit të Magjistraturës, ku përfshihet

Adresa:
Rruga "PAPA GJON PALI II"
Nr 3, Tiranë,



Email: info@akshi.gov.al
tel. +355(0)4.2277750
fax. +355(0)4.2277764

Pjesa e Administratës dhe Pjesa për Akses Publik, si regjistër i dixhitalizuar dhe elektronik”.

Sa më sipër, lutemi të na vendosni në dispozicion nga 1 (një) përfaqësues me qëllim ngritjen e grupit të punës sipas përcaktimit të mësipërm.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë që ka krijimi i këtij regjistri, si dhe numrin e aktorëve të përfshirë që janë të domosdoshëm për të qenë pjesë e procesit, duke qenë se kontributi i tyre do të reflektohet në mbarëvajtjen e sistemit dhe të të gjithë procesit në të ardhmen, lutem marrjen në konsideratë të zgjidhjes së propozuar nga ana jonë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Mirlinda Karçanaj

